

Të huajt në Shqipëri
Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)
INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave.....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	6
12. Rëndësia	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave	9
18. Përpunimi statistikor	9
19. Komente.....	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Popullsisë, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Saber Hasmujaj
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave të Popullsisë
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë.
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	shasmujaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / 240
1.8. Numri i faksit	+355 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	23/08/2024
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	23/08/2024
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	23/08/2024
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat mbi “Të huajt në Shqipëri” merr në konsideratë çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.</p> <p>Qëllimi i publikimit vjetor i të huajve në Shqipëri është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas grup-moshave dhe gjinisë, arsyes së aplikimit, vendeve të origjinës si dhe numrin vjetor të aplikimeve të lejeve të qëndrimit. Publikimi gjithashtu paraqet dhe të huajt e parregullt.</p> <p>Seritë e të dhënave mbi të huajt përmbajnë informacion statistikor mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës; • Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas gjinisë; • Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas grup-moshës; • Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas arsyes së aplikimit; • Të huajt e parregullt; • Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas kontinenteve;

	<ul style="list-style-type: none"> • Aplikimet për leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës; • Aplikimet për leje qëndrimi në Shqipëri sipas afatit të qëndrimit.
3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Klasifikimi i shtetësisë bazohet në listën e kodeve ISO-3166 (duke përdorur alfa-2) me ndryshime të vogla.</p> <p>Këto ndryshime konsistojnë në ndryshime të vogla që kanë ndodhur me kalimin e kohës për të pasqyruar krijimin e vendeve të reja ose shtetësive. Në disa raste, këto kategori të shtetësisë nuk janë të njohura botërisht, por përdoren dhe njihen nga Shqipëria.</p>
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Informacioni statistikor mbulon të dhënat për të huajt me leje qëndrimi sipas vendit të origjinës, arsyes së aplikimit, kontinenteve, gjinisë, grup-moshës, të huajt e parregullt si edhe aplikimet për leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.</p>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>I huaj është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.</p> <p>Leje qëndrimi është dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili autorizon dhe lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve.</p> <p>Person pa shtetësi është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.</p> <p>Leje pune është autorizimi i lëshuar nga autoriteti shtetëror përgjegjës, një të huaji, për qëllime biznesi, për t'u punësuar, vetëpunësuar ose për formim profesional.</p> <p>Bashkim familjar është hyrja dhe qëndrimi në Republikën e Shqipërisë të anëtarëve të familjes së një shtetasi shqiptar, të cilët nuk kanë shtetësinë shqiptare, ose të një të huaji, ose refugjati, banorë në Republikën e Shqipërisë, me synim ruajtjen e familjes, pavarësisht nëse marrëdhënia familjare krijohet para apo pas hyrjes së të huajit në Republikën e Shqipërisë, në rastet e bashkimit familjar të familjes së të huajit.</p> <p>Anëtarë të familjes së të huajit, azilkërkuessit, refugjatit apo personit nën mbrojtje plotësuese janë bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, bashkëjetesa e të cilit ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar; të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, përfshirë dhe ata të vendosur në regjim të kujdestarisë dhe që janë në ngarkim të tij ose të saj apo të birësuar me vendim gjykatë apo një vendimi që zbatohet drejtpërdrejt, sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose që duhet të njihet, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe fëmijët e rritur, të pamartuar, kur ata nuk mundin objektivisht të plotësojnë nevojat e tyre, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë, kur janë në ngarkim të tij, ose bashkëshortes/bashkëshortit, sipas legjislacionit të origjinës dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës.</p> <p>Shërbimi vullnetar është një program aktivitetesh solidarizuese, bazuar në veprimtari të njohura në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të objektivave të interesit të përgjithshëm.</p>

	<p>Studiues dhe specialist janë të huajt që kanë njohuri të specializuara, thelbësore, për shërbimin, pajisjet kërkimore dhe nivel të lartë kualifikimi për aktivitetin që ushtron ndërmarrja ose institucioni kërkimor.</p> <p>Qëndrim i parregullt është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson, ose nuk plotëson më kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Shtet apo vend i origjinës është shteti, shtetësinë e të cilit mban azilkërkuesi apo refugjati dhe, në rastin e personave pa shtetësi, shteti në të cilin refugjati apo azilkërkuesi ka vendbanimin e tij të zakonshëm.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është individi.
3.6. Popullata statistikore	Statistikat e të huajve u referohen individëve të huaj me leje qëndrimi në Shqipëri si dhe të huajt e parregullt.
3.7. Zona e referencës	Territori i Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Seritë kohore të “Të Huajve në Shqipëri” publikohen çdo vit, duke filluar nga viti 2017 e në vazhdim. Të dhënat e agreguara janë në nivel vendi. Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2005 dhe në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Numër individësh.
5. Periudha e referencës	Ky raport i referohet vitit 2023.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore për prodhimin e treguesve Të huajt në Shqipëri, është pjesë e bazës ligjore të INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.17/2018 "Për Statistikat Zyrtare"; • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026. <p>Konceptet statistikore dhe përkufizime bazohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.79/2021 "Për të Huajt".
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Aktualisht nuk ka shkëmbim të dhënash në nivel Evropian.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga njësitë statistikore konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore

	<p>në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 "Për statistikatat zyrtare", si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikatat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
<p>7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave</p>	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njërive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njërive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor;</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<p>8. Politika e botimit</p>	
<p>8.1. Kalendar i publikimeve</p>	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
<p>8.2. Akses në kalendarin e publikimeve</p>	<p>Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>
<p>8.3. Akses i përdoruesve</p>	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikatat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit,</p>

	<p>për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – publikim online; 2. Kërkesat e shkruara (me postë ose email); 3. Seksioni Kërkesa të dhënash, për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Statistikat për “Të huajt në Shqipëri” publikohen një herë në vit.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	<p>Sipas kalendarit të publikimeve, të dhënat për “Të huajt në Shqipëri” shpërndahen çdo vit me një publikim më vete, në data specifike. Publikimi mundësohet në faqen zyrtare të INSTAT, në bazën e të dhënave statistikore Pxweb, gjithashtu shpërndahen elektronikisht tek përdoruesit.</p> <p>Njoftimet dhe vonesat publikohen në kalendarin e publikimeve. Në rastin e vonesave, specifikohet data tjetër e botimit dhe shpjegimi i arsyeve të vonesave.</p>
10.2. Publikime	<p>Përdoruesit mund t’i gjejnë publikimet në faqen e internetit të INSTAT të organizuara nën temën:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të huajt në Shqipëri
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhëna më të detajuara për “Të huajt në Shqipëri” publikohen në faqen zyrtare të INSTAT: Databaza Statistikore
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Aksesit në të dhënat mikro nuk aplikohet.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesiioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë: Kërkesë të dhënash formulari .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Të dhënat janë siguruar nga burime administrative. Një shpjegim i shkurtër rreth përkufizimeve dhe metodologjisë për statistikave të huajve gjendet në faqen e INSTAT në seksionin lidhur me Metodologjinë mbi Statistikat e “Të huajt në Shqipëri”.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Popullsisë dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat për statistikave të huajve në Shqipëri për qëllime të brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” , INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit

	<p>të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës (kostos) të të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Kontrollet e vlerësimit të cilësisë së të dhënave janë veprime që kryen përgjatë tërë procesit.</p> <p>Burimi i të dhënave për Statistikat e Të huajt në Shqipëri është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Publikimi i të dhënave për të huajt kanë një përdorim të gjerë kryesisht për planifikimin e politikave bazuar në evidenca, sepse shifrat e të huajve përdoren për të analizuar një sërë treguesish social dhe ekonomik, nga përdorues të ndryshëm ndër të cilët më kryesorët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qeverisja qendrore; • Qeverisja lokale; • Bota Akademike; • Përdorues të zakonshëm. <p>Informacioni mbi nevojat e përdoruesve për të dhëna mbi të huajt, dhe perceptimet e tyre në lidhje me to matet në disa mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Klikimet e produktit përkatës në faqen zyrtare të INSTAT; • Takime me përdorues të ndryshëm duke lejuar ata të diskutojnë mbi kërkesat dhe nevojat e tyre; • Kontakte me përdorues të cilët kontaktojnë individualisht sektorin e Statistikave të Popullsisë mbi kërkesat e tyre specifike, apo dërgojnë në INSTAT kërkesat e tyre lidhur me statistikat për të huajt.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet në lidhje me Statistikat e Migracionit dhe Integrimi i Migrantëve për vitin 2023 janë 7,905.</p> <p>Gjatë 2023, INSTAT ka kryer vërtetimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vërtetimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Migracionit dhe Integrimi i Migrantëve është vlerësuar me 3,94 (78.8%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave për statistikat e “Të huajt në Shqipëri ” për vitin 2023 referuar treguesve të parashikuar në Programin e Statistikave zyrtare (2022-2026) mbuluar nga INSTAT është 100%.</p>

13. Saktësia dhe besueshmëria

13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton burimet përkatëse të të dhënave për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.

14. Afatet kohore dhe përpikmëria

14.1. Afatet kohore	Rezultatet e statistikave për Të huajt në Shqipëri janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 236 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 236 ditë). Periudha referuese e rezultateve Të huajt në Shqipëri është 31 Dhjetor 2023. <table border="1"><tr><td>Periudha referuese</td><td>12/31/2023</td></tr><tr><td>Data e publikimit</td><td>8/23/2024</td></tr><tr><td>Afatet kohore</td><td>236</td></tr></table>	Periudha referuese	12/31/2023	Data e publikimit	8/23/2024	Afatet kohore	236		
Periudha referuese	12/31/2023								
Data e publikimit	8/23/2024								
Afatet kohore	236								
14.2. Përpikmëria	Të dhënat e Statistikave për Të huajt në Shqipëri publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i të dhënave mbi “Të huajt në Shqipëri” ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve. <table border="1"><tr><td>Periudha referuese</td><td>12/31/2023</td></tr><tr><td>Data e shpallur</td><td>8/23/2024</td></tr><tr><td>Data e publikimit</td><td>8/23/2024</td></tr><tr><td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr></table>	Periudha referuese	12/31/2023	Data e shpallur	8/23/2024	Data e publikimit	8/23/2024	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2023								
Data e shpallur	8/23/2024								
Data e publikimit	8/23/2024								
Vonesa në kohë	0								

15. Koherenca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Statistikat për “Të huajt në Shqipëri” paraqiten në nivel vendi. Këto statistika janë të krahasueshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave.
15.2. Krahasueshmëria kohore	Statistikat për të huajt në Shqipëri datojnë që nga viti 2005 referuar databazës statistikore, duke siguruar një krahasueshmëri të gjatë kohore prej 19 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=19). Të dhënave ju bëhen kontrolle të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.

15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu vlerësimi i serive kohore dhe trendi i tyre.
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Sektori i Statistikave të Popullsisë është pjesë e Drejtorisë së Statistikave Sociale. Stafi i përfshirë në procedurat e mbledhjes së të dhënave nga burime administrative, kontrollit të të dhënave, përditësimit, përpunimit dhe mirëmbajtjes së statistikave punon me kohë të plotë dhe është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjës 1 punonjës. • Specialistë 3 punonjës. <p>Sa i përket të dhënave nga burimet administrativ ato janë pa kosto. Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet INSTAT dhe Ministrisë së Brendshme krijojnë mundësinë e transmetimit të të dhënave pa kosto.</p>
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit kryhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit; • Politika e trajtimit të gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast se burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi statistikën e të huajve në Shqipëri do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e ardhshëm shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Të huajt për vitin 2023”, subjekt i këtij raporti.</p>
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Për statistikën e të huajve burimi i të dhënave janë vetëm të dhëna administrative. Të dhëna mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri si dhe të huajt e parregullt sigurohen nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Referuar të dhënave mbi aplikimet për leje qëndrimi dhe lejeve të qëndrimit në territor, informacioni sigurohet nëpërmjet Regjistratit Elektronik për të Huajt (FER).</p>
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave realizohet me frekuencë vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Të dhënat mbi “Të huajt në Shqipëri” janë të dhëna me burim administrativ. Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave mbi “Të huajt në Shqipëri” për vitin 2023, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Departamenti për Kufirin dhe</p>

	Migracionin është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij programi.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave të papërpunuara u janë bërë kontrolle logjike dhe matematike të konsistencës brenda secilës tabelë apo midis tabelave të ndryshme që raportojnë të njëjtat të dhëna. Këto kontrolle kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit që INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të dhënave administrative mund të përmendim: kontrolli për plotëshmërinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet e nevojshme (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komente	
Aneks	